Numër: 01/85
Datë: 23.02.2024

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duke vendosur sipas ankesës Nr. 01/19 parashtruar me datë 25.01.2024 nga Institucioni "Oskar Kammer Schule" MBH-FT SH.P.K. me adresë: Rr. Vëllëzrit- Fazliu, Prishtinë, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr. 01/806 të datës 21.12.2023, në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 8 të Rregullores Nr. 01/196 të punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.02.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K" Nr. 01/19 e datës 25.01.2024, e ushtruar kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 01/806 të datës 21.12.2023.

2. Mbetet në fuqi vendimi Nr. 01/806, i datës 21.12.2023 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K" i pakënaqur me vendim e Këshillit Drejtues Nr. 01/806 të datës 21.12.2023, me datë 25.01.2024 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë pranë Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve e cila është protokolluar dhe ka marrë nr. 01/19, me pretendimet e aplikimit të gabuar të ligjit dhe akteve tjera juridike, shkeljes së Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 si dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli Drejtues pasi ka pranuar ankesën nga pala ankuese ka vendosur që përmes Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) t`i dërgoj ekspertëve ankesën e institucionit për të dhënë mendimet e tyre profesionale, bazuar kjo në obligimet që kanë ekspertët sipas marrëveshjes së

lidhur me AKK-në, që në raste të parashtrimit të ankesës kundër vendimit të KD të AKK-së, të përgjigjen në kërkesat e AKK-së në dhënien e mendimit profesional për kualifikimin për të cilin kanë përgatitur raportin e akreditimit dhe validimit. AKK me datë 12.02.2024 përmes zyrtarit të saj ka dërguar e-mail tek ekipet e ekspertëve duke kërkuar mendimin e tyre profesional.
Ekipi i ekspertëve me datë 16.02.2024 ka përpiluar një raport në ankesën e institucionit "Oskar Kammer Schule" për kualifikimet: Bashkëpuntorë Profesionale i Infermierisë dhe Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor, i cili në AKK është protokolluar dhe ka marrë Nr.01/71. Në këtë raport ekspertët kanë theksuar se: Ekipi i eksperteve i angazhuar në procesin e akreditimit dhe validimit për institucionin Oskar Kammer Schule MBH-FT SH.P.K në Prishtinë, ka dorëzuar raportet përfundimtare finale për akreditim dhe validim pas një procesi të vlerësimit të dokumentacionit dhe dy vizitave të realizuara në institucion, siç janë përshkruar edhe në raportin e punë të dorëzuar me datë 07.11.2023. ekipet e eksperteve kanë dhënë rekomandim pozitiv për raportin e akreditimit dhe validimit të institucionit "Oskar Kammer Schule MBH-FT SH.P.K" në raportet e dorëzuara për Bashkëpuntorë Profesionale i Infermierisë dhe Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor me datë 01.11.2023. Sipas eksperteve në takim Këshilli Drejtues ka diskutuar dy pika të raporteve tona:

1. Pjesa 4 e raportit të akreditimit pika 1 "Struktura e nevojshme institucionale dhe qëndrueshmëria financiare" dhe

2. Pjesa 4 e raportit për akreditim pika 6 "politikat dhe procedurat për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara"

Siç edhe mund t`i referoheni procesverbalit të mbledhjes për vërtitësin e qëndrimeve tona, ne për vlerësimin e pjesës së 4 të raportit për akreditim, pika 1 "Struktura e nevojshme institucionale dhe qëndrueshmëria financiare" kemi konstatuar se plotësohet pjesërisht për këto arsye:

a) Institucioni ka dorëzuar memorandum bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës nr 14-024/01119940/23, ku komuna i siguron hapësirë, mjete dhe material shkollor në shfrytëzim në SHMFU "Asim Vokshi", në Prishtinë.

b) Në planin financiar të dërguar nga institucioni, me nr. protokolli 48, zotohet se pronari i shkollës do të mbështes institucionin në aspektin financiar.

c) Institucioni ka paraqitur një deklaratë të përkthyer në gjuhën shqipe nga gjuha gjermane dhe të noterizuar me nr. protokolli 39, ku në paragrafin Menaxhimi dhe Kontrolli, përgjegjësinë e merr shkolla amë "Oskar Kammer Schule GmbH"

Ndërsa për pjesën 4 të raportit të akreditimit, pika 6 Politikat dhe procedurat për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara " kemi konstatuar se kriteri "plotësohet pjesërisht" për këto arsye:

a) Bazuar në memorandumin e bashkëpunimit me Komunën e Prishtinës ishte dhënë në shfrytëzim kati dytë i objektit të SHMFU "Asim Vokshi në Prishtinë" dhe gjatë vizitës nuk kishim dëshmi se do të vendoset ashensori.

b) Përfaqësuesit e institucionit janë zotuar se mund ta shfrytëzojnë edhe një pjesë të katit përdhesë nese paraqitet nevoja.

c) Objekti i shkollës publike është duke funksionuar dhe do të përdornim standard të dyfishtë. Kemi konstatuar se kriteret "plotësohen pjesërisht".

Si përfundim ne si ekspert të fushës qëndrojmë në rekomandimet e dhëna Pozitive në raportet e akreditimit dhe validimit, pra po ri përsërisim edhe një herë qëndrimin tonë profesional të cilin në ditën e takimit kemi thënë se nuk i ndërrojmë qëndrimet tona nga raportet finale se rekomandimi final për Këshillin Drejtues të AKK-së është sërish Pozitiv dhe ato që i kemi sqaruar anëtarëve të Këshillit Drejtues të AKK-së sipas pyetjes e cila na është drejtuar nga anëtarët e KD , nëse do të ndërrohen kriteret për pasqyrën financiare që janë diskutuar sikur të ishin dy opsion, ne kemi dhën përgjigjen tonë vetëm për atë pjesë të asaj pyetje dhe si duket ajo është nxjerrë nga kontesti i diskutimit tonë dhe është bërë vërtetim i gabuar nga ana juaj, pasi sqarimi ynë ka qenë vetëm për atë pyetje dhe jo për të raportin , sepse në tërësi raportet janë pozitive. Dhe asnjëherë nuk kemi thënë se rekomandimi jonë final për raportet të validimit dhe akreditimit është Negativ.

Sa i përket dëshmive që janë bashkangjitur në ankesë tani situata është edhe më e qartë se institucioni përmes zotimit të dytë e ka sqaruar më mirë mbështetjen financiare sipas rekomandimeve në raportin e validimit dhe akreditimit, po ashtu ka ofruar edhe pasqyra financiare për 4 vitet e fundit që shihet sa ka qarkullim të mjaftueshëm dhe na jep siguri për mbështetje.

Kjo pikë që ishte vlerësuar nga ne si ekip i eksperteve si: plotësohet pjesërisht tani kjo pikë sipas vlerësimit tonë vlerësohet si: Plotësohet. Po ashtu sipas eksperteve tani edhe pjesa 4 pika e raportit të akreditimit plotësohet sepse pala ankuese ka ofruar dëshmi të reja.

Këshilli Drejtues pasi analizoj raportin e eksperteve konstatoj se institucioni/ pala ankuese këto dëshmi i ka bashkangjitur me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi raportet përfundimtare të eksperteve janë dorëzuar në Këshill Drejtues dhe pasi Këshilli ka marrë vendimin. Andaj, bazuar në nenin 20 paragrafi 4 i Udhëzimit Administrativ Nr.35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Nuk mund të përdoren dëshmi të reja për ta apeluar vendimin e validimit apo akreditimit. Nëse ka informata apo dëshmi të reja të cilat nuk janë paraqitur më parë, për institucionin aplikues do të jetë e nevojshme që ta përgatisin një aplikacion të ri për validim apo akreditim.

Andaj, Këshilli Drejtues konstatoj se ekspertet në këtë fazë nuk mund të bëjnë vlerësim të ri me provat e reja sepse institucioni këto kritere bazuar në dispozitat ligjore në fuqi është dashtë t`i plotësonte gjatë fazës së vlerësimit të institucionit nga ana e eksperteve ku u është dhënë e drejta për komente shtesë në raportet e përpiluara nga ekspertet duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor në këtë çështje administroj këto prova:

- Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 01/806 i marrë me datë 21.12.2023;
- Ankesën e Institucionit "Oskar Kammer Schule" MBH-FT SH.P.K të parashtruar me datë 25.01.2024 dhe të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë;

- Raportet vlerësuese të ekipeve të eksperteve për akreditim dhe validim të Institucionit "Oskar Kammer Schule" MBH-FT SH.P.K për kualifikimet Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë niveli 3 dhe 4 sipas KKK, si dhe Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor niveli 3 dhe 4 sipas KKK, të datës 24.10.2023.

- Emalin e zyrtarit të AKK-së të datës 12.02.2024 drejtuar ekipeve të ekspertëve për dhënien e vlerësimit profesional mbi ankesën Nr. 01/19 e dt. 25.01.2024 e ushtruar nga Institucioni "Oskar Kammer Schule";

- Raportin vlerësues të ekipit të ekspertëve në ankesën e institucionit "Oskar Kammer Schule" MBH-FT SH.P.K nr. 01/71 të datë 20.02.2024.

Këshilli Drejtues i AKK-së shqyrtoj pretendimet ankimore të palës ankuese e cili i ka parashtruar kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 01/806, të datës 21.12.2023.

Këshilli Drejtues i AKK-së pasi shqyrtoj ankesën me të gjitha shkresat e lëndës, raportet përfundimtare të ekipit të eksperteve si dhe raportin e eksperteve Nr. 01/71 të datës 20.02.2024 lidhur me ankesën e palës ankuese ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga institucioni "Oskar Kammer Schule" MBH- FT SH.P.K- është e pa bazuar sepse:

Pretendimet e ankuesit të dhëna si në ankesë se kemi aplikim të gabuar të ligjit dhe akteve tjera juridike nuk qëndrojnë dhe janë të pa bazuara, për faktin se me qellim të një vendimmarrje të drejt Këshilli Drejtues në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 21.12.2023 ku pikë e rendit të ditës për shqyrtim kanë qenë edhe raportet vlerësuese përfundimtare të eksperteve për validim dhe akreditim për institucionin "Oskar Kammer Schule" MBH-FT SH.P.K ka ftuar ekipet e eksperteve pët të dhënë sqarime shtesë rreth përpilimit të raporteve sa i përket plotësimit të kushteve dhe kritereve për akreditim dhe validim nga ana e institucionit. Pyetje drejtuar eksperteve ka qenë: a ka ofruar institucioni dëshmi me të cilën faktohet/provohet qëndrueshmëria financiare e tij, sepse në raportin vlerësues të dhënë nga ekspertët, tek plotësimi i kritereve sa i përket strukturës së nevojshme institucionale dhe qëndrueshmërisë financiare thuhet se ky kriter plotësohet pjesërisht. Ndërsa siç është cekur edhe në raportin përfundimtar të përpiluar nga ekipi i eksperteve, sipas tyre institucioni edhe gjatë takimit/vizitës kanë theksuar se Shkolla Oskar Kammer Schule ka planifikim të mbështetjes financiare nga Shkolla Oskar Kammer Schule në Gjermani, mirëpo nuk ka prezantuar ndonjë dokument që ka dëshmuar se garanton alokimin e mjeteve financiare. Po ashtu institucionit i kanë rekomanduar të dëshmohet mbështetja financiare e shkollës nga Oskar Kammer Schule në Gjermani, megjithatë sipas ekspertëve edhe gjatë takimit/vizitës nuk u është prezantua ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet qartë mbështetja financiare për institucionin.

Këshilli kërkoj sqarim nga ekipi i ekspertëve edhe sa i përket plotësimit të kritereve pjesa 4 pika gjashtë (6) e raportit vlerësues për akreditim që ka të bëjë me politikat dhe procedurat për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara, ku në raportin vlerësues për akreditim për institucionin ekipi vlerësues i ekspertëve ka theksuar se kjo pikë plotësohet pjesërisht dhe tek pjesa e arsyetimit është cekur se objekti nuk përmbush kushtet për qasje për nxënësit me aftësi të kufizuara, sepse shkolla Oskar Kammer Schule ka planifikuar të shfrytëzoj hapësirën e katit të dytë të objektit, derisa nuk ka as ashensor dhe as pjerrina për mundësi të lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara. Para Këshillit Drejtues ekspertët kanë ofruar sqarime shtesë duke theksuar se objekti nuk përmbush kushtet për çasje për nxënësit me aftësi të kufizuara, nuk ka ashensor e as

pjerrina për qasjen e nxënësve dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe theksuan faktin se shkolla ka planifikuar që mësimin ta mbaj në katin e dytë të objektit.

Andaj pretendimi e ankuesit se raportet e validimit dhe akreditimit për të dyja kualifikimet kanë qenë tërësisht pozitive, dhe se ekspertet e kanë konfirmuar këtë nuk qëndrojnë sepse bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) 35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë neni 10 paragrafi 1 pika 1.1 përcakton se: "për tu akredituar një institucion që aplikon duhet ti përmbush kriteret si në vijmë dhe të ofroj dëshmi: Strukturë të përshtatshme institucionale e cila funksionon në bazë të qëndrueshmërisë financiare (p.sh. Planifikimi i zhvillimit strategjik për tri vite, raporti i qarkullimit vjetor apo dëshmi nga banka për mbulesë financiare". Prandaj nga të lart theksuarat Këshilli Drejtues konstatoj se institucioni nuk ka përmbushur këtë kriter sepse i njëjti nuk kishte ofruar dëshmi ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi.

Pretendimet e ankuesit se Këshilli Drejtues ka shkelur nenin 4.1. të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative nuk qëndron sepse KD ka vendosur duke u bazuar në Ligjin nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, prandaj veprimet administrative janë marrë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së, ku neni 8 paragrafi 1 pika 1.4 i Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, përcakton se: Institucionet ofruese apo vlerësuese të akredituara duhet ti përmbushin kriteret e akreditimit. Mos përmbushja e këtyre obligimeve do të rezultojë me refuzim të akreditimit. Andaj, mbi këtë bazë ligjore ka arsyeshmëri të plotë Vendimi Nr.01/806 i datës 21.12.2023 i Këshillit Drejtues.

Pretendimi i ankuesit se KD ka diskriminuar parashtruesin e ankesës kur ka refuzuar akreditimin dhe validimin duke shkelur neni 6 të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative nuk qëndron sepse AKK ka bërë vlerësimin duke respektuar të gjitha dispozita ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, KD me rastin e shqyrtimit dhe analizimit të raporteve vlerësuese ka gjetur se institucioni nuk ka plotësuar kriteret ashtu siç parashihen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.35/20214 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

Pretendimi i palës ankuese se neni 11 paragrafi 1.4 i UA 35/2014 përcakton që KD i AKK merr vendim vetëm për akreditim të kualifikimit dhe se UA 35/2014 askund nuk i referohet mos akreditimi është i pa bazuar, sepse neni 8 paragrafi 1 pika 1.4 i Udhëzimit Administrativ Nr.35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, përcakton se: Institucionet ofruese apo vlerësuese të akredituara duhet ti përmbushin kriteret e akreditimit. Mos përmbushja e këtyre obligimeve do të rezultojë me refuzim të akreditimit.

Po ashtu sipas palës ankuese KD ka shkelur neni 17 paragrafi 1 dhe 2 të UA 35/2014 sipas të cilit Këshilli Drejtues do të marrë vendim bazuar në rekomandimet nga raporti i eksperteve nuk qëndron, sepse KD me qellim të vërtetimi të drejtë të gjendjes faktike ka ftuar ekipet e eksperteve në takim për ofrim të sqarimeve shtesë dhe në bazë të deklarimeve të eksperteve dhe të gjeturave në raportet vlerësuese të ekspertëve KD vërtetoj gjendje faktike ndryshe dhe konstatoj se këto dy kritere nuk plotësohen nga ana e palës ankuese.

Pretendimi i palës ankuese se KD ka vendosur në kundërshtim me pritjet legjitime të palës ankuese dhe në kundërshtim me neni 95 të LPPA-së është i pa bazuar.

Neni 96 paragrafi 1 pika 1.3 parasheh të drejtën e vendosjes pa u dëgjuar pala në rast se: Pala tashmë i ka shprehur plotësisht gjatë procedurës, mendimet e veta rreth rezultatit të shqyrtimit administrativ dhe rezultatit të mundshëm të procedurës. Pala ankuese gjatë gjithë procesit të vlerësimit nga ana e eksperteve, përfshirë dorëzimin e aplikacionit fillestar, vizitat e ekipeve të eksperteve në këtë institucion, pranimin e draft raporteve të eksperteve për të dhënë komente shtesë i dorëzuar tek pala ankuese me datë 11.09.2023, përgjigjen në kërkesë e institucionit e datës 10.10.2023. KD bazuar në nenin 11 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01.521 e për përcaktimin e procedurave për aplikimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, ka respektuar të drejtën e palës ankuese për tu dëgjuar dhe për të ofruar dëshmitë e nevojshme para se raportet përfundimtare të eksperteve të dërgohen në Këshill Drejtues për vendimmarrje. Andaj, KD ka vepruar bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pala ankuese duke u thirrur në neni 94 të LPPA, ankesës i ka bashkangjitur prova të reja pasqyrën financiare ato të viteve 2018-2023 mbi qarkullimin financiar të palës ankuese, me qellim të përmbushjes së kriterit të qëndrueshmërisë financiare si dhe konfirmimin nga gjuha gjermane i përkthyer në gjuhën shqipe ku konfirmohet se shkolla "Oskar Kammer Schule GmbH" nga Gjermania deklaron gatishmërinë e saj për të ofruar mbështetje për palën ankuese në Kosovë. Pala ankuese ka bashkangjitur si provë konfirmimin e datës 24.01.2024 dhe atë të datës 10.01.2024.

Po ashtu, sa i përket përmbushjes së kriterit për personat me aftësi të kufizuara institucioni i ka bashkangjitur ankesës si provë fotot ku sipas tyre komuna ka vendosur rrethoja në kuadër të pjerrinave që shërbejnë për këtë kategori, ku i mundësohet qasje me e lehtë. Sipas palës ankuese këto rrethoja të vendosura nuk kanë qenë të përfshira në raportin e eksperteve dhe janë prova të reja që ankuesi prezanton, duke kërkuar që të njëjtat të merren parasysh me rastin e shqyrtimit të ankesës. Pala ankuese ka ofruar edhe dëshminë e komunikimit me komunën e Prishtinë dt. 24.01.2024 sipas të cilës vërtetohet se komuna do të vendos ashensor për qasje në shkolla, sipas të cilëve do të përmbushet kriteri që lidhet me qasjen e personave me aftësi të kufizuar në shkollë.

Këshilli Drejtues bazuar në neni 20 paragrafi 4 i Udhëzimit Administrativ Nr.35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, konstatoj se ky pretendim i palës ankuese është i pa bazuar duke qëndruar pas vendimit të tij Nr. 01/806 i datës 21.12.2023.

Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e vendosjes në ankesë është mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Udhëzimin Administrativ(MASHT) Nr. 35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren e Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/196 e dt. 25.05.2021, si dhe në Ligjin për Procedurën e përgjithshme Administrative.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve pasi shqyrtoj dhe analizoj ankesën e Institucionit "Oskar Kammer Schule" MBH-FT SH.P.K dhe provat e bashkangjitura në ankesë, raportet vlerësuese përfundimtare të ekipeve të eksperteve si dhe raportin e eksperteve Nr. 01/71 lidhur me ankesën e palës ankuese, vërtetimit të gjendjes faktike dhe në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën Kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Hapja e Konfliktit Administrativ nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së